

**PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË
KUVENDI KOMBËTAR**

VENDIM NR. _____, DATË 18.12.2021

Në mbështetje të nenit 43 të Statutit, Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike, në mbledhjen e datës 18 Dhjetor 2021,

Në përmbushje të përgjegjësisë të veta politike dhe statutore, si organi më i lartë vendimmarrës i Partisë Demokratike;

Në funksion të të ardhmes së PD-së dhe të Shqipërisë, të mbrojtjes së vlerave Euro-Atlantike dhe të parimeve themelore të saj, të mbajtjes gjallë të shpresës së të nesërme dhe të jetësimit të aspiratës mbarëkombëtare për një Shqipëri si Europa, riafirmim fuqimisht se vlerat Euro-Atlantike, parimet e etikës konservative dhe të moralit politik, marrëdhëniet e ngushtë dhe e paekuivok me SHBA-të janë të paprekshme;

Duke mbështetur të gjithë vendimarrjen e deritanishme të Këshillit Kombëtar, të Kryesisë së Partisë dhe të Kryetarit që nga Kuvendi Kombëtar i 17 Korrikut 2021;

Duke e parë të ardhmen e vendit në udhëkryq dhe të ardhmen e Partisë Demokratike të kërcënuar nga jehona të së shkuarës, nga një frymë revanshiste që kërkon të delegitimojë dhe shkatërrojë opozitën, nga flukse me frymëzim dhe ide antidemokratike dhe kundër vlerave identitare të pro-amerikanizmit dhe pro-europeizmit;

VENDOS:

- 1- Shpallja non grata nga qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës është e papajtueshme me çdo funksion drejtues në Partinë Demokratike të Shqipërisë.
- 2- Të mbështesë fuqimisht iniciativën për dekomunistizimin e vendimarrjes dhe përfaqësimit politik në të gjitha institucionet shtetërore dhe publike dhe partitë politike.
- 3- Kuvendi ngarkon organet e Partisë Demokratike për zbatimin e këtij vendimi.
- 4- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KOMISIONIT TË DREJTIMIT TË PUNIMEVE TË KUVENDIT